



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 21 prot.

Kamëz, më 22.02.2024

V E N D I M

Nr 19 Datë 22/02/2024

**“PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR 106 DATE 18.12.2023
PER MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE TË BASHKISË KAMËZ DHE
NDËRMARRJEVE TË VARTËSISË PËR VITIN 2024”.**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.22/02/2024, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin **nr.16 dt 19/02/2024**,

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM-në nr. 625, datë 28.09.2022 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore” lidhja nr.8, në VKM –në nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” vendimit nr. 113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

V E N D O S I

1. Ndryshimin e e nivelit të pagës të punonjësve të policisë bashkia Kamez sipas lidhjes për funksionet e zgjedhura dhe të emëruara, paga e grupit dhe shtesa për pozicion për nëpunësit civilë të Bashkisë Kamëz sipas klasave të përcaktura në V.K.M nr 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes

vendore”, VKM-në nr. 625, datë 28.09.2022 “Per disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur të nepunesve civil e të punonjësve administrativ të njësive të vetë qeverisjes vendore” lidhja nr.8, në VKM –në nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, sipas Lidhjes IV .

Niveli I pagave per punonjesit e Policise Bashkiake

Lidhja nr.4

Nr.	Pozicioni	Kategoria /Klasa	Grupi	Shtesa per vjetersi	Shtesa per pozicion
I	Punonjes te sistemit me page grupi+ shtese pozicioni		1	2	3
1	Drejtor Drejtorie	II-b	1	2%	80,300
2	Pergjegjes Sektori	III-b	1	2%	78,000
3	Inspektor i Policie Bashkiake	IV-b	1	2%	56,000
4	Polic I policies Baskiake/asistent	Sipas pikes 11, VKM 328/2023	1	2%	47,000

2. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen pas miratimit te ketij projekt vendimi.
3. Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut.

NEN/KRYETAR I KESHILLIT

